

Nr	Drejtoria/Struktura	Arsimi dhe kualifikimet e drejtuesve/CV	Detyrat funksionale
1	Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas	CV	<p>Drejtori i Përgjithshëm i DNJF drejton veprimtarinë e DNJF e përfaqëson atë dhe vepron në emër të saj. Ai është kreu administrativ i këtij institucioni i cili është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të politikave shtetërore në fushën e ndihmës juridike nga ana e institucionit; ndarjen e detyrave të drejtorive përbërëse si dhe sigurimin e koordinimit ndërmjet tyre me institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtori i Përgjithshëm i DNJF planifikon, organizon dhe menaxhon punën e Drejtorëve të DNJF në mënyrë të tillë që të sigurohet që hartimi dhe zbatimi i politikës që ndiqet të jetë i mirë-koordinuar dhe eficient. 2. Drejtori i Përgjithshëm i DNJF angazhohet në detyrat e mëposhtme funksionale: <ol style="list-style-type: none"> a) Përfaqëson Drejtorinë në marrëdhënie me palët e treta; b) Raporton në hark kohor 3 mujor dhe vjetor pranë Ministrisë së Drejtësisë për aktivitetin e Drejtorisë në lidhje me zbatimin e ligjit për ndihmën juridike falas si dhe politikës shtetërore në fushën e ndihmës juridike; c) Propozon/ shqyrton ligjin dhe projekt-aktet nënligjore të dala në zbatim të legjislacionit në fuqi për ndihmën juridike dhe ja përcjell ato për propozim Ministrisë së Drejtësisë; d) Studion dhe analizon objektivat, nevojat dhe problematikat në funksionimin e DNJF dhe merr masa për realizimin e përmirësimit të tyre; e) Ndjek përdorimin e fondeve financiare dhe burimeve të tjera financiare të ligjshme; f) Realizon kontrole për performancën e Drejtorëve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe përcakton objektivat vjetorë të performancës; g) Mbikëqyr veprimtarinë e drejtorive përkatëse në kuadër të zbatimit të detyrave dhe të ligjit dhe akteve nënligjore; h) Lidh kontrata me organizatat jofitimprurëse si dhe klinikat ligjore për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të këtij ligji; i) Lidh kontrata me avokatët pjesë e listës së miratuar nga Dhoma e Avokatisë Shqipërisë;, ofruar të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore; j) Miraton, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, programin e trajnimit fillestar dhe atë vazhdues për punonjësit të cilët ofrojnë ndihmë ligjore parësore për qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore; k) Miraton, në bashkëpunim me Dhomën e Avokatisë së

			<p>Shqipërisë, programin e trajnimit të posaçëm dhe atë vazhdues për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore;</p> <p>l) Miraton çdo dokument të brendshëm që lidhet me organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë si dhe qendrave të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore që ka në administrim;</p> <p>m) Autorizon me shkrim një nga Drejtorët e Drejtorive që ta zëvendësojë atë gjatë mungesës së tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>n) Realizon kontrata me persona fizikë e juridikë kombëtarë e ndërkombëtarë, kur kërkohet ekspertizë e veçantë në kryerjen e detyrave, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;</p> <p>o) Propozon ndryshime në ligjin për ndihmën juridike në bazë të problematikave të hasura në praktikë;</p> <p>p) Kryen detyra të tjera bazuar në misionin e drejtorisë apo që i caktohen në ligje dhe/ose akte nënligjore.</p> <p>q) I raporton dhe jep llogari të drejtëpërdrejtë Ministrit përgjegjës për Drejtësinë, si dhe kur Ministri ka përcaktuar shprehimisht me urdhër, i raporton edhe çdo njësie tjetër raportimi në aparatit përgjegjës lidhur me realizimin e detyrave të planit të punës, planit financiar dhe veprimtarive të tjera të drejtorisë, si dhe për çështje të tjera për të cilat kërkohen raportime nga Ministri.</p>
--	--	--	---